

VENDIM
Nr. 189, datë 15.3.2017

**PËR TRAJTIMIN ME USHQIM TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË
STUDENTËVE DHE TË KURSANTËVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE TË
POLICISË SË SHTETIT, SI DHE TË SHTETASVE TË NDALUAR OSE TË
ARRESTUAR, DERINË SQARIMIN
E POZITËS SË TYRE**

(Ndryshuar me VKM-në nr. 765, datë 20.12.2023)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të nenit 67, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të drejtën e përfitimit të trajtimit me ushqim e gëzojnë strukturat, si më poshtë:
 - a) Punonjësit e Policisë së Shtetit:
 - i. me një vakt “drekë”, kur kohëzgjatja e punës është 8 (tetë) orë;
 - ii. me tri vakte, kur punonjësi është i angazhuar në gatishmëri, në shërbime për ruajtjen e rendit, sigurimin dhe mbarrëvajtjen e procesit zgjedhor, për përballimin e situatave emergjente dhe të fatkeqësive natyrore, aktivitete të ndryshme apo tubime, kur kohëzgjatja e punës është më shumë se koha normale e punës prej 8 (tetë) orësh.
 - b) Të gjithë studentët, kursantët dhe instruktorët në institucionet arsimore dhe në institucionet e Policisë së Shtetit brenda vendit:
 - i) me një vakt “drekë”, kur kohëzgjatja e trajnimit është 1 (një) ditë pune, 8 (tetë) orë;
 - ii) me tri vakte, kur kohëzgjatja e trajnimit është më shumë se një ditë pune. Për ditën e parë të trajnimit, trajtimi me ushqim do të bëhet për vaktet “drekë” e “darkë” dhe për ditën e fundit të trajnimit, trajtimi do të bëhet për vaktet “mëngjes” e “drekë”.
 - c) Trajtohen me tri vakte ushqim, pa pagesë, edhe kategoritë e mëposhtme:
 - i) shtetasit e huaj që hyjnë ilegalisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, deri në sqarimin e pozitës së tyre;
 - ii) shtetasit shqiptarë të kthyer nga vendet e tjera, deri në sqarimin e pozitës së tyre;
 - iii) shtetasit e ndaluar ose të arrestuar, deri në sqarimin e pozitës së tyre ose deri në transferimin e tyre në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP).
 - ç) Punonjësit e Qendrës së Edukimit Fizik dhe Sporteve Elitare, në Akademinë e Sigurisë, trajtohen me tri vakte ushqim pa pagesë.
2. Normat e ushqimit ditor të k/kalorive për të gjitha strukturat përfituese të përmendura në pikat e mësipërme të këtij vendimi përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Shëndetësisë, ku përcaktohen:
 - a) normat e artikujve ushqimorë, brenda limitit të miratuar të k/kalorive, duke ruajtur raportin e njësisë ushqimore;
 - b) normat e pajisjeve dhe të materialeve të shërbimit të ushqimit.
3. Përfitimi i trajtimit me ushqim bëhet i gatuar në mensa ose, kur nuk është e mundur, jepet në formën e një kompensimi financiar, sipas rregullave të përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi.
4. Shuma e kompensimit financiar transferohet në një llogari të posaçme bankare, të hapur nga punonjësi, në bankat e nivelit të dytë, e cila ka si qëllim përdorimin vetëm për trajtimin me ushqim të punonjësve të Policisë së Shtetit, sipas rregullave të kësaj pike. Llogaria e posaçme bankare mund të përdoret vetëm nëpërmjet një karte të posaçme që lejon kryerjen e

transaksioneve bankare vetëm në njësi tregtare ushqimore ose rrjete të tyre. Rregullat dhe procedurat për përdorimin e kartës së posaçme në njësitë tregtare ushqimore ose rrjetet e tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm.

4/1 Masa e vlerës për kompensimin në lekë për çdo normë të trajtimit me ushqim është për:

a) normën ditore të ushqimit me një vakt “drekë”, në vlerën 450 (katërqind e pesëdhjetë) lekë;

b) normën ditore të ushqimit me tri vakte, në vlerën 840 (tetëqind e dyzet) lekë.

4/2 Vlerat e kompensimit në lekë të normave ditore të ushqimit, të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 4/1, të këtij vendimi, rriten me të njëjtën masë, si dhe masa e indeksimit të pagave të të punësuarve në institucionet e administratës publike, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

5. Fondi i përcaktuar për këtë qëllim planifikohet për çdo vit në programin buxhetor të Policisë së Shtetit.

5/1 Përyjashtimisht për vitin 2023, shuma e kompensimit financiar, të përcaktuar në pikën 4/1, të këtij vendimi, transferohet në llogarinë bankare të pagës për të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit, që përfitojnë kompensimin financiar.

6. Vendimi nr. 702, datë 21.8.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me ushqim të punonjësve të Gardës së Republikës, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të studentëve dhe kursantëve në shkolla të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar deri në sqarimin e pozitës së tyre”, nuk zbatohet për punonjësit e Policisë së Shtetit, studentët dhe kursantët në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe për shtetasit e ndaluar apo të arrestuar, deri në sqarimin e pozitës së tyre.

7. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme¹ për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ VKM nr. 765, datë 20.12.2023 botuar në F.Z. nr. 190, datë 27.12.2023 në kreun II dhe III të tij shprehet: “II. Efekti financiar për vitin 2023 mbulohet nga buxheti i Ministrisë së Brendshme.

III. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2023.”